

RAPORT I PERKOHSHEM 1 17 – 30 May 2005

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Me 3 Korrik 2005, zgjedhesit shqiptar do te zgjedhin 140 anetaret e Parlamentit. Kushtetuta e Shqiperise parashikon qe 100 prej tyre zgjidhen drejtperdrejte nga listat njeemeroe dhe 40 prej tyre zgjidhen nga listat shumeemeroe te partive apo koalicioneve politike. Ky sistem i nderlikuar duket sikur ka lejuar disa parti te lidhin aleanca jozyrtare me qellim rritjen e numrit te mandateve qe ata mund te marrin. Strategji te tilla mund te ulin efikasitetin e sistemit zgjedhor ne permbushjen e objektivave kushtetuese per te nderfutur nje shkalle proporcionaliteti ne sistemin zgjedhor.
- Zgjedhjet do te zhvillohen sipas Kodit Elektorale te miratuar ne vitin 2003 dhe amenduar ne vitet 2004 dhe 2005. Legjislacioni zgjedhor siguron nje baze te pershtatshme per nje zhvillim demokratik te zgjedhjeve. Megjithate, shtrirja pergjate se ciles ligji do te kete nje ndikim pozitiv ne procesin zgjedhor, ne fund percaktohet nga vullneti politik – kryesisht i institucioneve shtetore dhe partive politike – per zhvillimin e zgjedhjeve demokratike dhe sipas ligjit.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) po mban seanca te vazhdueshme ne menyre transparente dhe kolegjiale. Por, diskutimet shpesh kane qene te zgjatura dhe KQZ eshte vonuar ne pershtatjen e rregulloreve te nevojshme per procesin zgjedhor. Disa parti, vecanerisht Partia Demokratike, kane vonuar pavend emerimin e disa anetareve te Komisioneve te Zonave Zgjedhore (KZZ). Rrjedhimisht, jo te gjitha KZZ-te ishin ne gjendje pune ne fund te muajit Maj.
- Listat e zgjedhesve mbeten nje pike diskutimi. Disa nga shqetesimet e shprehura nga interlokutoret ishin lidhur me defektet kryesore administrative, problemin e pjesetareve te familjes te ndare ne dy zona zgjedhore, lenien jashte te tyre, perseritjes se mundshme te emrave ne disa lista si dhe nje numer te konsiderueshem qytetaresh, vendbanimi i te cileve nuk mund te verifikohet.
- Aktualisht, 57 parti jane regjistruar per te konkuruar ne zgjedhje. Fushata eshte tashme ne rrugen e saj, dhe shume aktivite te saj jane zhvilluar, me fushatat e Partise Socialiste dhe Partise Demokratike me te dukshme. Shfaqja e partive te reja mund te zgjeroje rrezet e zgjedhjes se zgjedhesve.
- Media ka mbuluar shume aktivite te fushates. Rezultatet e para te monitorimeve deshmojne se media ka mbuluar fushaten elektorale te PS dhe PD gati ne perjashtimin e fushatave te partive te tjera. Toni i perdorur nga mediat elektronike eshte vezhguar deri tani nga Misioni i Vezhgimit te Zgjedhjeve (MVZ).

II. PREZANTIM

Si pergjigje te fteses se Qeverise Shqiptare per te vezhguar zgjedhjet parlamentare te 3 Korrikut 2005, OSCE/ODIHR solli Misionin e Vezhgimit te Zgjedhjeve (MVZ) me 17 Maj. Zyra e OSCE/ODHIR (MVZ) drejtuar nga Jørgen Grunnet (me kombesi Daneze), perbehet nga 35 eksperte ne fushen e zgjedhjeve dhe vezhgues afatgjate te ardhur nga 17 shtete anetare te OSCE-se. Zyra e OSCE/ODIHR MVZ ka shperndare vezhgues afatgjate ne 11 qytete te Shqiperise. Zyra e OSCE/ODIHR-it i ka kerkuar shteteve anetare te ndihmojne me 400 vezhgues afatshkurter per te vezhguar procesin e votimit dhe numerimit te votave.

Zyra e OSCE/ODIHR Misioni i Vezhgimit te Zgjedhjeve operon vecmas nga prezenca e OSCE-se ne Shqiperi, e cila kryesohet nga Ambasadori Pavel Vacek, i cili vazhdon te ushtroje aktivitetin e tij normal sipas mandatit ekzistues. Megjithate, zyra e OSCE/ODIHR-it eshte shume mirenjohese per mbeshtetjen e madhe qe i ka dhene prezenca e OSBE-se ne Shqiperi.

Nje koalicion me vezhgues shqiptare eshte formuar per te vezhguar zgjedhjet qe po vijne. Ata duan te shperndajne 3500 vezhgues ne te gjithë vendin. Organizata e Rrjetit European per Vezhgimin e Zgjedhjeve (OREVZ), nje grup prej 17 organizatash civile nga 16 vende te rajonit te OSBE, kane si qellim te shperndajne 6 vezhgues afatgjate dhe 60 vezhgues afatshkurter.

III. PERSHKRIM ZGJEDHOR

Zgjedhjet parlamentare te vitit 2005 do te jene te gjashtat qe nga vendosja e sistemit shume partiak ne vitin 1991. Qe atehere, dy partite e medha PS dhe PD kane dominuar skenen politike. Mosbesimi i dyanshem dhe rivaliteti i theksuar, perfshire edhe mes dy kryetareve te partive, kane cuar ne nje polarizim te skajshem politik. Shpesh bllokime politike ne ceshtje si reforma zgjedhore jane kapercyer vetem me nderhyrjen e institucioneve nderkombetare, vecanerisht OSBE-ja.

Partia Socialiste, drejtuar nga Kryeministri Fatos Nano, ka numrin me te madh te vendeve, 73, ne parlamentin ekzistues¹, me mbeshtetjen e dy anetareve te parlamentit qe kandiduan si kandidate te pavarur dhe 13 qe kandiduan nga kater parti te tjera, blloku drejtues ze 88 vende nga 140 vende te Kuvendit². Ne vitin 2001, koalicioni opozitar "Bashkimi per fitore", i cili nder te tjera perfshinte Partine Demokratike, te drejtuar nga Sali Berisha, Partine Republikane, Partine Levizja e Legalitetit dhe Partine e Ballit Kombetar mori 46 vende³. Partia Demokratike e Re mori 6 vende.

Zhvillime te fundit te politikës perfshijne themelimin e Levizjes Socialiste per Integrim⁴ (LSI) e kryesuar nga ish-kryeministri Ilir Meta si dhe shfaqjen ne skenen politike te nje grupimi te ri politik te quajtur Levizja per Zhvillim Kombetar – Leka Zogu⁵(LZHK).

Historikisht, Partia Demokratike gezon perkrahjen me te madhe ne veri te vendit, ndersa Partia Socialiste mbeshtetet mjaft mire ne Jug. Rajoni qendror duket te jete nje pike e forte diskutimi.

¹ PS u deklarua fituese ne 73 zona nje-emerore. Ajo nuk mori asnje vend nga listat zgjedhore partiake.

² Partia Social Demokrate (4 vende), Partia Agrare (3 vende), Partia e te Drejtave te Njeriut (3 vende) dhe Partia Aleanca Demokratike (3 vende). Keta parlamentare u zgjodhen te gjithë permes listave zgjedhore te partive.

³ Bashkimi per Fitore mori 21 vende nga zonat zgjedhore dhe 25 permes listave partiake.

⁴ LSI-ja u nda nga Partia Socialiste dhe mori 9 vende ne Parlament te zgjedhur si kandidate te Partise Socialiste ne 2001 ne zonat zgjedhore nje-emerore.

⁵ LZHK-ja perbehet nga dy parti te krahut te djathte: Partia Demokratike e Rinovuar (PDR) dhe Partia Levizja per Legalitet(PLL) si dhe nje parti jo-parlamentare Partia Konservative.

Partia per te Drejtat e Njeriut (PBDNJ) kerkon mbeshtetjen e minoriteteve kombetare, vecanerisht komunitetin shqiptar qe flet greqisht, qe ndodhet kryesisht ne Jugun e skajshem.

Gjashtembedhete parti politike kane rene dakord te firmosin Kodin e Etikes te inicuar nga Presidenti i Shqiperise, Alfred Moisiu, duke kerkuar nder te tjera, bindje ndaj ligjit dhe te permbahen gjate fushates.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR

Kushtetuta e Shqiperise parashikon qe Parlamenti te perbehet nga 140 deputete. Njeqind prej tyre zgjidhen direkt nga zonat zgjedhore njeemerore me nje raund zgjedhor me kandidat qe kerkojne shumicen, por jo shumicen absolute te votave per tu zgjedhur⁶. 40 deputetet qe mbeten zgjidhen nga listat e partive apo koalicioneve partiake. Per te patur te drejten e ketyre 40 vendeve, partite politike ose koalicionet partiake duhet te kalojne perkatesisht pragun prej 2.5 dhe 4 % te votave te vlefshme.

Ndersa Kushtetuta percakton nje sistem zgjedhor ne te cilin mbi 71% te mandateve fitohen me ane te parimit “te shumices”, ne nenin 64.2 kerkohet qe “numri total i deputeteve te nje partie ose koalicioni partiak duhet te jete, sa me afer qe te jete e mundur, raportit te votave qe ata kane fituar ne shkalle kombetare ne raundin e pare te zgjedhjeve”. Keshtu, Kodi Elektoral parashikon qe 40 anetare te parlamentit “te zgjidhen sipas perqindjeve proporcionale te votave te fituara nga listat shumeemerore”.⁷

Ne fakt, ndarja e ketyre mandateve eshte e lidhur me numrin e vendeve te shumices te fituara nga partia ose koalicioni ne zonat zgjedhore nje-emerore. Per cdo parti ose koalicion, neqoftese numri i vendeve te fituara ne mazhoritar tejkalon numrin total te vendeve, qe do te kishte fituar sipas votave proporcionale, kjo parti ose koalicion nuk gezon te drejten per pjesemarrje ne ndarjen e vendeve shtese. Per cdo parti apo koalicion, neqoftese numri i vendeve te fituara ne mazhoritar eshte me i vogel se numri i vendeve qe do te kishte fituar sipas votave proporcionale, kjo parti apo koalicion fiton te drejten per pjesemarrje ne ndarjen e vendeve shtese. Rrjedhimisht keto vende ndahen duke iu perafuar numrit te vendeve qe partia apo koalicioni perkates do te zere sipas votimit ne sistemin proporcional.⁸

Kodi Zgjedhor (Neni 90) parashikon qe zgjedhesi voton me dy flete votimi: njera per konkurimin e drejtperdrejte ne zonen zgjedhore te ciles i perket dhe nje tjetere ne konkurimin ne nivel kombetar. Keshtu, zgjedhesve u lejohet te bejne dy zgjedhje te vecanta elektorale. Kjo vecori i lejon partite te zhvillojne disa strategji duke formuar koalicione zgjedhore jozyrtare. Strategji te tilla mund te ulin efikasitetin e sistemit zgjedhor ne zbatim te qellimeve kushtetuese per injektimin e nje shkalle proporcionaliteti ne sistemin zgjedhor.

⁶ Ne zgjedhjet parlamentare te meparshme, kandidateteve i duhej 50% e votave te vlefshme per tu zgjedhur. Nqse asnjeri nga kandidatet nuk siguronte numrin e kerkuar te votave, dy kandidatet me numer me te madh votash kalonin ne balotazh.

⁷ Kodi Zgjedhor, Neni 65

⁸ Formula e sakte per shperndarjen e mandateve plotesuese percaktohet nga Neni 67 i Kodit Zgjedhor.

V. STRUKTURA LIGJORE

Kodi Zgjedhor eshte miratuar ne Korrik te vitit 2003 dhe amenduar ne Tetor 2004, Janar 2005 dhe Prill 2005. Legjislacioni aktualisht ne fuqi siguron nje baze te pershtatshme per zgjedhje demokratike. Megjithate, sic eshte permendur edhe me siper, shtrirja pergjate se ciles ligji do te kete nje efekt pozitiv ne zgjedhje se fundmi do te percaktohet nga vullneti politik - kryesisht i institucioneve shtetore dhe partive politike – per zhvillimin e zgjedhjeve demokratike dhe sipas ligjit.⁹

Dispozitat ligjore qe percakton Kodi Zgjedhor plotesohen nga udhezime te publikuara nga KQZ. Por, ne nje rast, nje udhezim i KQZ-se le jashte nje nga kerkesat e Kodit Zgjedhor, duke iu referuar rolit te policise si shoqeruese te materialeve zgjedhore ne qendren e numerimit pas mbylljes se votimit. Udhezimi kerkon vetem qe polici te siguroje “shoqerimin”, ndersa Neni 109/1 i Kodit Zgjedhor kerkon qartesisht qe polici te hyje bashke me anetaret e KQV *ne makinene qe transporton votat*. Kjo gje perben shqetesim per perfaqesuesit e MVZ-se se OSCE/ODIHR qe policet mos gabimisht besojne se jane cliruar nga detyrimi ligjor i te qenit te pranishem ne makinene e transportit. Ka akoma kohe per KQZ-ne te sqaroje kete ceshtje dhe te shmang ndonje keqinterpretim te mundshem.

VI. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Administrata zgjedhore me tre nderlidhje do te administroje zgjedhjet: KQZ-ja, 100 KZZ dhe 4,762 Komisione te Qendrave te Votimit (KQV). Per here te pare ne zgjedhjet Shqiptare, votat do te numerohen ne 100 Qendra Votimi, nje per cdo zone.

KQZ-ja eshte nje organizem i perhershem i perbere nga shtate anetare me mandate shtate-vjecare. Dy anetare emerohen nga Kuvendi, dy nga Presidenti i Republikes dhe tre nga Keshilli i Larte i Drejtesise, me ndikim te konsiderueshem nga partite politike ne procedurat e emerimit. Ne baze te nje marreveshjeje te arritur nga PD dhe PS ne Tetor 2004, “ekuilibri politik” i KQZ-se u ndryshua ne menyre te tille qe pozicioni mbizoterues i shumices parlamentare (5 ne 7) te zvogelohet, duke i dorezuar nje vend opozites. Sipas ligjit, shume vendime merren me shumice votash, por nje shumice prej 5 votash nevojiten per dokumentimin e rezultateve te zgjedhjeve, anulimin e zgjedhjeve dhe per vendimet mbi ankesat kunder vendimeve te KZZ lidhur me rezultatet e zgjedhjeve.

Cdo KZZ perbehet nga shtate anetare, me tre propozime nga parti te cdo krahu te spektrit politik, ndersa anetari i shtate emerohet ose nga partia me e madhe drejtuese (PS) ose nga partia me e madhe opozitare (PD) ne baze barazie, qe percaktohet nga “perzgjedhja e rastit” dhe “shperndarja e barabarte”. Partite kane te drejten te zevendesojne anetaret e KZZ-se ne cdo kohe. Kjo mund te coje ne paqendrueshmeri te punes se administrates zgjedhore. Ne te vertete, KQZ-ja miraton zevendesimin e anetareve te KZZ-se pothuajse perdite. KQV-te dhe skuadrat e numerimit te votave emerohen nga KZZ-te sipas te njejtës formule qe emerohen KZZ-te. Koha shume e shkurter per emerimin e grupeve te numerimit te fleteve te votimit (dy ore para mbylljes se votimeve) perben shqetesim, sepse mund te shkaktoje probleme persa i perket pergatitjes se duhur te grupeve te numerimit te fleteve te votimit.

⁹ Per hollesira te metejshme: ‘Raporti i Vleresimit te Nevojave’ i pergatitur nga OSBE/ODIHR, Varshave (29 Prill 2005), fq 6-8.

KQZ-ja po mban seanca dy here ne dite. Gjate muajve te fundit ka miratuar disa udhezime dhe ka marre rreth 400 vendime, se shumti mbi formimin e KZZ-ve dhe regjistrimin e partive. Qe nga 20 Maji, MVZ-ja e OSCE/ODIHR ka ndjekur te gjitha seancat e KQZ-se. Pergjithesisht, keto seanca jane zhvilluar ne nje atmosfere kolegjiale dhe diskutimet jane transparente, por seancat ishin te zgjatura, duke vonuar keshtu miratimin e disa udhezimeve dhe vendimeve te rendesishme. Megjithate, ne kete faze, kjo situatë nuk duket te kete krijuar probleme te medha ne organizimin e zgjedhjeve.

Sipas ligjit, te gjitha KZZ-te duhet te jene emeruar jo me vone se data 3 Mars 2005. Por, meqe kufinjte e zonave zgjedhore te ricaktuara nuk ishin perfunduar me 3 Mars, KQZ e shtyu afatin e fundit deri me 16 Maj. Megjithate, vetem 63 nga 100 KZZ u krijuan ne afatin ligjor te rivendosur, sepse disa parti politike, vecanerisht Partia Demokratike, nuk i emeruan anetaret. Faktikisht, 49 KZZ nuk e bene inaugurimin sipas planifikimit. Rrjedhimisht, disa KZZ nuk ishin ne gjendje te marrin pjese ne raundin e pare zyrtar te trainimit mes 20 dhe 23 Majit.

Disa Vezhgues Afatgjate ndoqen disa seanca trainimi te KZZ-ve dhe per pjesen me te madhe raportuan te kene qene te organizuara mire dhe te drejtuara profesionalisht. Disa KZZ nuk jane formuar akoma plotesisht, disa nuk jane kompjuterizuar apo i mungojne mjetet e komunikimit dhe pak prej tyre nuk kane godina. Vonesa ne formimin e KZZ-ve do te kete efekt demtues ne proces. Keshtu, eshte raportuar se nje kandidat i LSI-se ne rajonin e Shkodres nuk mundi te regjistrohej sepse KZZ-ja nuk ishte ne gjendje pune. Afati i fundit i regjistrimit te kandidateve nuk ka perfunduar akoma.

VII. REGJISTRIMI I ZGJEDHESVE

Pergjegjesia per hartimin dhe mirembajtjen e listave te zgjedhesve i eshte deleguar autoriteteve te qeverisjes vendore nga KQZ, te cilet gjithashtu mbajne edhe regjistrat civile. Megjithate, ne ligj nuk percaktohet per vendosjen e nje regjistri qendror zgjedhesish. Ministria e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit ndermori pergjegjesine per kontrollimin e versioneve elektronike te listave paraprake te zgjedhesve, te derguara nga njesite e qeverisjes vendore, per perseritje te mundshme te emrave dhe nje shperndarje te crregullt te dukshme. Ministria duhet te informoje Kryetaret e Bashkive ne minibashkite per kete shqetesim.

Ne menyre qe te zbatohet legjislacioni i ri zgjedhor, i cili kerkon hartimin e listave te reja te zgjedhesve, ishte e nevojshme reformimi i sistemit te procedurave civile dhe regjistrimit te zgjedhesve. Listat paraprake te zgjedhesve bazohen ne regjistrat civile, listat e zgjedhesve te perdorura ne vitin 2003 dhe procesi i verifikimit duke shkuar shtepi per shtepi. Te gjithë shtetasit figuronin me nje adrese prej dhjete shifrash numerike dhe u hartuan listat e reja kompjuterike te zgjedhesve nga autoritetet vendore. Ky proces ishte nje sfide e madhe, jo vetem per shkak te levizjeve te medha te popullsisë, por dhe nje shkalle e larte 'jozyrtare' ne planifikimin e ndertesave te reja, hezitimet e mundshme te disa shtetasve per regjistrimin e banesave te tyre te reja dhe periudha e shkurter kohore brenda se ciles duheshin hartuar listat paraprake te zgjedhesve.

Ne baze te ligjit, listat e zgjedhesve duhej te ishin shpallur per shqyrtim publik nga dt. 1 Prill (Neni 64/2 – dispozita kalimtare) deri me dt. 3 Maj (Neni 58.1). Nje fushate per informim te gjere publik u organizua me qellimin per te informuar zgjedhesit per te drejtat dhe detyrat e tyre lidhur

me regjistrimin e zgjedhesve. Ministria e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit urdheroi shtyerjen e afatit, fillimisht deri me dt. 20 Maj dhe se fundmi deri me dt. 30 Maj, ne menyre qe zgjedhesit te kishin kohe ne dispozicion per te kontrolluar listat. Listat e zgjedhesve duhet te perfundojne deri me dt. 8 Qershor. Pas mbylljes se periudhes se regjistrimit, shtetasit te cilet nuk jane te perfshire ne listen e zgjedhesve, mund te votojne ne Diten e Zgjedhjeve vetem nese aplikojne dhe marrin nje vendim nga gjykata e rrethit 24 ore perpara Dites se Zgjedhjeve. Me dt. 17 Maj, Ministria e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit njoftoi per 202,000 duplikime te identifikuar, ku 70,000 prej tyre ishin zgjidhur. Me dt. 31 Maj, Ministria raportoi qe kishte fshire rreth 55% te duplikimeve te identifikuar.

Vezhguesit e OSCE/ODIHR-it kane raportuar qe lista e zgjedhesve mbetet nje ceshtje e diskutueshme midis disa prej personave, psh: ne Durres, Vlore, Shkoder dhe Fier. Ndersa disa prej shqetesimeve kane te bejne me gabimet administrative, te tilla si: emrat e personave te vdekur qe duhen hequr nga listat, anetaret e familjes te ndare ne dy zona votimi, lenia jashte listes e personave, shperndarja e crregullt e zgjedhesve ne qendrat e votimit, dhe nje numer i konsiderueshem i perseritjes se emrave ne lista. Zyra e OSCE/ODIHRit Misioni per Vezhgimin e Zgjedhjeve ka marre informacione qe nje numer i madh zgjedhesish mbarojne me numer identifikimi '999' (me poshte 'hyrjet 999'), qe tregon se keta shtetas nuk jane verifikuar nga grupet e verifikimit ne banesat ne te cilat ata figurojne te regjistruar si rezident (banues).

Ne Vlore, jane raportuar ndryshime thelbesore midis numrit te zgjedhesve te regjistruar ne vitin 2003 dhe listave paraprake te zgjedhesve ne vitin 2005¹⁰. Per shkak te perfshirjes te nje numri te konsiderueshem 'hyrjesh 999' ne listat e zgjedhesve ne Vlore dhe Durres, disa qendra votimi kane me teper se 1000 zgjedhes te regjistruar – maksimumi qe lejon ligji. Ne Tirane, ne zonen 38, ka patur nje konflikt mbi deshtimin per te regjistruar 1400 studente si zgjedhes ne Tirane.

Ndersa zyrtaret e minibashkive shprehin besimin qe listat e zgjedhesve do te jene te rregullta Diten e Zgjedhjeve, ne shume raste, partite ne opozite me partine ne fuqi ne nivel lokal pohojne qe listat jane politikisht te manipuluar. Perfshirja e mundshme e regjistrimeve civile te papershtatshme ne listat e zgjedhesve mund te kene kontribuar ne numrin e madh te 'hyrjeve 999' dhe nje rritje te dukshme te numrit te zgjedhesve te regjistruar krahasuar me vitin 2003.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATIT

Te gjitha forcat kryesore politike po kontestojne zgjedhjet. 57 parti jane regjistruar si subjekte elektorale ne KQZ. Numri perfundimtar i partive, koalicioneve dhe kandidateve qe do te kontestojne zgjedhjet do te behet e ditur vetem pas dt. 3 Qershor 2005, afati i fundit i regjistrimit te partive dhe koalicioneve ne KQZ dhe regjistrimi i kandidateve ne KZZ.

PS dhe aleatet e saj ne koalicionin ne fuqi kane njoftuar publikisht qe ata do te kontestojne zgjedhjet vecmas. Megjithate, PS ka informuar zyren e OSCE/ODIHR MVZ, qe nuk perjashton mundesine qe mund te konkludojne marreveshje ne nivel lokal. Pervec kesaj, nje nga partite ne koalicionin ne fuqi tregon per OSCE/ODIHR MVZ, qe bashkepunimi midis PS dhe aleateve ne koalicionin ne fuqi ishte i domosdoshem dhe ne fakt do te ndodhe.

¹⁰ Numrat e votuesve te regjistruar per keto dy zgjedhje ne zonat 94-96 variojne mes 13.000 dhe 20.000 per zone.

PD ka mbyllur marreveshjet me 8 parti politike¹¹ (me poshte partite partnere), nepermjet te cilave do te lejoje kandidatet nga partite partnere te kandidojne nen flamurin e PD ne 15 zonat zgjedhore nje-emerore. Sipas marreveshjes, partite partnere te PD do te inkurajojne mbeshtetesit e tyre te perkrahin kandidatet e PD ne kandidimin ne zonat nje-emerore ne shkembim te mbeshtetjes se PD per listat e tyre partiake. Megjithate, ne kohen e ketij raporti nuk eshte aprovuar asnje marreveshje koalicioni nga KQZ. LSI dhe LZHK kane deklaruar ne public qe partite do te kontestojne zgjedhjet si subjekte te vecanta.

IX. MEDIA

Kodi Elektoral u jep te drejte partive te perfitojne minutazh falas ne median publike, koha e se ciles varet nga perfaqesimi i partive ne Parlament. Me ligj, edicioni i lajmeve ne stacionet private dhe publike te radios dhe televizioneve duhet te jete ne perputhje te parimeve te njejta. Me perjashtim te Televizionit publik RTSH, partite politike dhe kandidatet e pavarur kane te drejte te transmetojne reklama politike te paguara¹², volumi i te cilave gjithashtu varet nga perfaqesimi i partive ne Parlament. Ne menyre te qarte keto dispozita favorizojne partite e medha.

Gjithashtu, Kodi Elektoral u jep te drejte transmetuesve private te transmetojne debate elektorale (por qe ata te ruajne ekuilibrin midis forcave politike pjesemarrrese), ndalon komunikimin e propagandas politike nga gazetaret gjate edicioneve te lajmeve dhe detyron KQZ te ngreje dhe emeroge Bordin e Monitorimit te Medias (BMM) pergjegjese per monitorimin dhe zbatimin e dispozitave perkatese te Kodit Elektoral. Ky Bord u vendos me dt. 26 Maj. Ai duhet t'i raportoje KQZ cdo dite, dhe KQZ sipas rastit merr vendime ose sanksione. Monitoruesit e medias ne nivel lokal emerohen nga BMM per monitorimin e transmetimeve nga transmetuesit lokale.

Me dt. 17 Maj, zyra e OSCE/ODIHR MVZ filloi monitorimin e 3 stacioneve televizive kombetare per 6 ore cdo dite (nga ora 18:00–00:00), lajmet kryesore te nje stacioni tjetër televiziv (Top Channel) dhe gjashte gazeta te perditshme¹³. Zyra e OSCE/ODIHR-it MVZ do te kryeje nje analizim cilesor dhe sasior, do te identifikojte temat e fushates, dhe do te vleresoje respektimin e dispozitave ligjore qe mbulojne fushaten ne media.

Megjithese fushata zyrtarisht fillon me dt. 3 Qershor, tashme e tere media pasqyron prezantimin nga partite te kandidateve te tyre dhe platformen ne programet aktuale dhe perkatese. Rezultatet paraprake te monitorimit na tregon qe media mbulon aktivitetet e partive kryesore duke perjashtuar pothuajse te tjeret. Eshte matur toni i medias elektronike. Pasqyrimi i medias se shtypur ka qene me shume antagonist.

X. FUSHATA ELEKTORALE

Aktivitetet e fushates jane mjaft te dukshme ne gjithe vendin. Ne menyre domethenese, krahasuar me zgjedhjet e meparshme, fushatat e partive kane tendencen te perqendrohen me shume ne programet dhe platformat e tyre. Megjithate, fushata e PS ka theksuar ngjarjet e vitit 1997 gjate te

¹¹ Keto parti jane: Partia Demokratike e Re (PDRP), Partia Republikane (PR), Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Demokristiane (PDK), Levizja per te Drejtat dhe Lirite e Njeriut (LDLN), Partia Balli Kombetar (PBK), Parti Balli Kombetar Demokratik (PBKD) dhe Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar.

¹² RTSH nuk lejohet me ligj te transmetojte reklama politike me pagese.

¹³ Stacionet televizive jane: *TVSH, TV Arberia, TV Klan and Top Channel*. Gjashte gazetate e monitoruara jane: *Shekulli, Panorama, Korrieri, Gazeta Shqiptare, Tema dhe Koha Jone*.

cilit ligji dhe rregulli u shkelen dhe PD e ka perqendruar fushaten e saj rreth pretendimeve per korrupsion te partise ne fuqi. Vezhguesit afatgjate kane marre akuza per blerje te votes dhe kercentime duke perfshire ketu presion mbi nenpunesit, megjithese keto akuza nuk jane te mbeshetura.

Kodi Elektoral parashikon financimin publik te fushates elektorale. KQZ ka akorduar per kete qellim 60 milion leke Shqiptare (perafersisht 480.000 Euro). Sipas vendimit te KQZ dt. 5 Maj, gjysma e shumes se akorduar duhet te ishte shperndare midis te gjitha partive qe kane marre me shume se 2.5% te votave ne zgjedhjet e vitit 2001. Si shtese te fondeve publike, subjektet elektorale mund te perfitojne donacione private deri ne 1 milion leke shqiptare (8.000 euro) per donacion. Jo me vone se 45 dite pas zgjedhjeve, subjektet elektorale duhet te paraqesin raportet financiare prane KQZ, duke justifikuar shpenzimet e fushates dhe listen e donacioneve te marra.

XI. KONFLIKTET ELEKTORALE

KQZ ka autoritetin kryesor per gjykimin e ankimeve gjate fushates. Megjithese disa ankime zgjedhore mund te ankimohen ne KZZ, pjesa me e madhe e ceshtjeve te shkalles se pare do te dergohen prane KQZ. Gjithashtu KQZ ka juridiksionin per rishikimin e nje vendimi te KZZ. E drejta per te ankimuar nje ankese ose apel i takon 'subjektit elektoral', qe eshte nje parti politike, koalicion ose kandidat. Perjashtimi i vetem nga ky rregull lejon nje shtetas te kerkoje nga gjykata e rrethit per perfshirjen e tij ne listen e zgjedhesve. Ne varesi te sakesise se listave perfundimtare te zgjedhesve, kjo dispozite mund te jete domethenese.

Rishikimi gjyqesor i vendimit te KQZ mund te ankimohet nga subjekti elektoral brenda 5 diteve nga marrja e vendimit prane Kolegjit Elektoral te Gjykates se Apelit, Tirane. Kolegji Elektoral, i perbere nga 8 gjykates te zgjedhur me short nga gjykatat e apelit ne tere Shqiperine, vendosin mbi ceshtjet ne kolegje te perbere nga 5 anetare, te zgjedhur po ashtu me short. Neni 174 i Kodit Elektoral parashikon qe vendimi i Kolegjit Elektoral eshte i formes se prere dhe nuk mund te apelohet. Megjithate, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion mbi disa ceshtje lidhur me "zgjedhjen e deputeteve, si dhe verifikimin e zgjedhjes se tyre"¹⁴. Deri tani, Zyra e OSCE/ODIHR-it MVZ eshte ne dijeni vetem per dy ceshtje mbi zgjedhjet ankimuar ne Kolegjin Elektoral lidhur me zgjedhjet parlamentare 2005: Nje ceshtje eshte mbi apelimin e nje vendimi te KQZ mbi mekanizmat per zevendesimin e vezhguesve dhe ceshtja tjetere ka te beje me zevendesimin e nje anetari te KZZ. Per asnjeren nga ceshtjet nuk eshte marre nje vendim.

Prane zyres se OSCE/ODIHR-it MVZ kane ardhur 10 ankesa nga kater parti te ndryshme politike. Gjashte prej tyre bazohen mbi shqetesimin per listat e zgjedhesve, dy fajesoje partite per organizimin e fushates perpara dt. 3 Qershor, nje ka per objekt mbulimin nga media, dhe nje tjetere per caktimin e qendrave te numerimit te votive. Ankesat per listat e zgjedhesve nuk mund te vleresohen pasi jane ende ne proces shqyrtimi. Zyra e OSCE/ODIHR-it MVZ do te ndjeke nga afer shqyrtimin e konflikteve elektorale.

**Ky eshte versioni shqip i Raportit te Perkohshem 1
Por, versioni i vetem zyrtar mbetet dokumenti ne anglisht.**

¹⁴ Kushtetuta e Shqiperise (Neni 131)

